



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 18.06.2025

PROCESVERBAL

Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuara (gra, vajza, pensionistë, persona me nevoja të veçanta, të rinj dhe komunitete joshumicë) për

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028

I mbajtur më 13.06.2025 (e premte)

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuara (gra, vajza, pensionistë, persona me nevoja të veçanta, të rinj dhe komunitete joshumicë) për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 27.05.2024.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks.gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Kalendari-uebfaqen-zyrtare.pdf>
Boshnjakisht: <https://dragash.rks.gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Kalendari-uebfaqen-zyrtare-Serb.pdf>

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

Komuna e Dragashit

Opština Dragash

**02 Nr. Br. 400/01-10196/125
18.06.2025
Dragash - Dragash**

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1AdelUgfAf/>
Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/16jM695fL3/>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në **ora 11:00** dhe ka përfunduar në **ora 12:00**.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **34 pjesëmarrës**, prej tyre **25 meshkuj** dhe **9 femra**.

Kryetari i Komunës së Dragashit, z.Bexhet Xheladini, e bëri hapjen e këtij takimi dhe i përvendoset që gjithë të pranishmit në këtë dëgjim buxhetor.

Bexhet Xheladini: Ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë debat publik lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore! Sot do të flasim për Buxhetin e Komunës së Dragashit, më gjerësisht për Buxhetin e vitit 2026 dhe projekcionet për vitet 2027-2028. Si kryetar i Komunës së Dragashit, bazuar në Statutin e Komunës, bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin për Menaxhimin e Financave Lokale dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, jam i obliguar që për çdo vit fiskal të organizojmë së paku tri dëgjime buxhetore me grupe të ndryshme të interesit, ku qytetarët kanë mundësi të informohen për buxhetin e Komunës, dhe nga ju të marrim propozimet konkrete se ku duhet të shpenzohet ky buxhet.

Uzair Hamza: Përvendetje të gjithëve. Ajo që është e rëndësishme për komunitetet jo-shumicë është që buxheti të ndahet në mënyrë proporcionale bazuar në numrin e banorëve. Vitin e kaluar, rreth 4 milionë, diku afér 1 milion e shtatëqind mijë për komunitetet, me një përqindje mbi 41.3 për qind, dhe kjo është përgjegjësia ime si shef i zyrës që të kujdesem që buxheti të ndahet në mënyrë proporcionale. I ftoj përfaqësuesit e fshatrave të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre për investime kapitale. Zyra për komunitetet merr kërkesat nga përfaqësuesit e fshatrave dhe më pas i përpunon më tej këto kërkesa. Gjithashtu, dua të bëj apel që përfaqësuesit të kenë kujdes për personat me nevoja të veçanta. Ka raste kur përfaqësuesit nuk marrin parasysh nevojat e këtyre personave dhe, për shembull, shmangin të rregullojnë rrugët që përdoren nga ata. Më pas familjet e tyre individualisht vijnë tek ne dhe kërkojnë ndihmë. Pra, është shumë e rëndësishme që para kësaj të mbahen takime në fshatra dhe të përcaktohen priorititet. Dua të theksoj se kur flasim për financimin e OJQ-ve, kam detyrimin si shef i zyrës të informoj se komuna ka shpallur tender për projekte në fushën e sportit dhe kulturës. Fatkeqësish, aty nuk mund të bëhet një ndarje e drejtë, sepse konkurrojnë OJQ-të; për shembull, në fushën e sportit kemi pak organizata. Por kur flasim për Ditën e Diasporës, nga 35 mijë, rreth 25 mijë janë dhënë OJQ-ve nga Gora dhe 10 mijë për Opojën. Pra, brenda se kush do të marrë më shumë e kush më pak nuk është detyrë e Zyrës, por e Komisionit, sipas vlerësimeve të tyre. Gjithashtu, luten qytetarët të koordinohen me përfaqësuesit e fshatit dhe të mos vijnë individualisht duke kërkuar që të bëhen kubëzime apo diçka të ngjashme. Sa i përket Dragashit, ne bashkëfinancojmë projekte që kërkojnë të dyja komunitetet, duke marrë parasysh se Dragashi është një mjedis multietnik.

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Diskutimi i Uzairit ishte shumë i rëndësishëm, me e njofte opinionin publik, sepse kohëve të fundit po ka edhe propaganda të ndryshme, edhe dezinformata. Unë si kryetar i Komunës, vazhdimisht jam angazhuar që kur të vjen puna e buxhetit të zbatojë ligjin, dhe çdo herë kemi bërë ne diskriminim pozitiv, sa i përket ndarjes proporcionale të buxhetit, ku çdo herë komuniteti joshumicë ka marrë mjete më shumë se 41.3%. Çfarëdo lloj komision mundet me u

formue edhe me e vërtetue këtë. Pa i përfshirë edhe donacionet, të cilat për komunitetin joshumicë janë shumë më të mëdha dhe vijnë, ato nuk i kemi shti fare në llogaritje, se me ato sigurisht mbi 60% të mjeteve janë për komunitetin joshumicë. Po kalojmë te Buxheti. Ministria e Financave, gjegjësisht Qeveria e Kosovës, është kompetente për me e caktue lartësinë e buxhetit të çdo komune. Unë po i përmendi disa kritere, në bazë të të cilave Qeveria e ndan buxhetin për komuna. Kriteri bazë është kriteri i popullsisë, pra numri i banorëve, Ju siç e dini, deri vitin e kaluar buxheti ynë ka qenë më i madh sepse e kemi pas numrin e popullsisë më të madh. Tani më nuk i kemi 34 mijë banorë, por i kemi 28,896 banorë. Kemi rënë nën 30 mijë. Kështu që, ne kemi humbur në këtë drejtim. Kriter tjetër për caktimin e lartësisë së buxhetit është sipërfaqja e komunës. Gjithashtu, është përqindja e minoriteteve që jetojnë në komuna. Pastaj numri i nxënësve, numri i shkollave, numri i çerdheve, numri i objekteve shëndetësore. Kjo janë disa kritere bazë nga të cilat ndahet buxheti. Për këtë vit, buxheti i Komunës së Dragashit është 13,254,881 euro. Buxheti nuk është i kryetarit, nuk është i qeverisë komunale, buxheti është i juaji, i qytetarëve. Ju duhet të bëni kërkesa dhe ne, në bazë të kërkesave tuaja, i orientojmë ato mjete, sidomos ato të investimeve kapitale. Nga këto 13 milionë euro, për arsim janë 4,741,000 euro; për shëndetësi janë 1,661,000 euro; për Investime Kapitale këtë vit i kemi 4 milionë, ndërsa vitin e kaluar i kemi pas 4 milionë e 700 mijë euro; sa u përket Shpenzimeve Komunale, i kemi 400 mijë euro; dhe Subvencione 400 mijë euro, nga këto 90 mijë euro i ndan Zyra e Kryetarit për nevoja të njerëzve të sëmurë. Siç e dini, me kërkesën e grave asambleiste, ne kemi marrë një vendim që çdo grua e cila vuan nga kanceri i gjirit, t'u ndahan nga 500 euro. Për bujqësi do t'i ndajmë 100 mijë euro, për kulturë vitin e ardhshëm do t'i ndajmë 150 mijë euro, dhe për bursa do t'i ndajmë 60 mijë euro. Nga këto mjete, afér 7 milionë kanë me shkue për paga, shtesa dhe mëditje, apo 52% e buxhetit; Mallra dhe Shërbime 12 % e buxhetit; Shpenzime Komunale 3% e buxhetit; Subvencione 3% e buxhetit; dhe Investime Kapitale 30% e buxhetit. Sa i përket buxhetit, unë nuk dua t'ju humbas kohën tuaj, por para se ju ta merrni fjalën, e kisha lut drejtorin e Financave që ta marrë fjalën.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Përshtësuar kryetar, përshtësuar për të gjithë ju të pranishëm! Realisht, në shtylla të trasha i tha të gjitha kryetari dhe bëri një analizë shumë të mirë. Sa i përket buxhetit, KAB-i përcaktohet nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Qeverisë së Kosovës. Ju e dini që gjatë këtij vitit kemi pak ngasje në konsolidimin e institucioneve, si të Kuvendit ashtu edhe të Qeverisë, dhe Qarkorja e Parë Buxhetore na ka ardhë pak me vonesë dhe e pamiratuar në Kuvendin e Kosovës. Kështu që, me Qarkoren e Dytë Buxhetore, ne shpresojmë se do të kemi edhe një rritje të lehtë të buxhetit komunal. Për këtë çështje kemi mbajt edhe dy takime të mëhershme. Një numër i fshatrave i kanë pru edhe kërkesat e tyre. Sot kemi për qëllim që sa më shumë

nga gratë, nga grupet e nënpërfaqësuara, që të bashkëbisedojmë dhe të marrim kërkesat e tyre, që të mund t'i inkorporojmë në KAB. Dhe, gjithashtu, Grupi Punues për Buxhet të bëjë ndarjen e këtij buxheti. Kryetari tregoi se 6,941,000 euro janë të parapara për Paga; 1,513,000 euro janë për Mallra dhe Shërbime; 400 mijë euro janë Shpenzime Komunale; Subvencione janë 400 mijë euro; dhe 4 milionë janë për Investime Kapitale. Sa u përket mjeteve për investime kapitale dhe kërkesave që ju do t'i parashtroni, Grupi Punues do t'i ketë parasysh, pasi t'i marrim në rishqyrtim në takimet e ardhshme. Prandaj, pa dashtë me ju marrë më shumë kohë, unë do t'ju kisha lut që të hapim bashkëbisedimin dhe kërkesat të cilat i keni, ose në baza individuale, ose në grupe të ndryshme, mund t'i paraqitni, kështu që ne në takimet tjera do të shohim, ato prioritete të cilat janë më të rëndësishme do t'i sistemojmë dhe do t'i kemi parasysh që t'i mbulojmë me buxhet.

Zikrija Mehmedoviç, banor i fshatit Baçkë: Përrshëndetje të gjithëve. Në radhë të parë dua të theksoj furnizimin me ujë të pijshëm, nëse mund të përfshihet kjo në investimet kapitale. Gjithashtu, edhe rregullimin e parkingjeve, vendpushimit dhe rikonstruktimin e ndriçimit publik, pasi tashmë kemi ndriçim publik. Po ashtu, kemi një kërkesë në lidhje me rrugën Baçkë-Zlipotok; kjo rrugë që kur u hap nuk është prekur më, dhe përdoret rrreth 20% edhe pse është rrugë me dhe, që duhet të rregullohet pak me valjak, dhe atëherë përdorimi do të rrrejt ndoshta deri në 50%. Po ashtu kërkojmë që në disa pika kritike të ndryshohet trasa dhe të përmirësohet gjendja. Këto kërkesa duhet t'i paraqesin edhe përfaqësuesit e Zlipotokut dhe Globocicës, pasi edhe ata përdorin këtë rrugë. Faleminderit.

Nesim Hodza, banor i fshatit Restelicë dhe gazetar: Përrshëndetje të gjithëve. Deri tani kemi dëgjuar shumë mbështetje dhe shumë fonde, por z. kryetar, ku jemi ne si media në buxhetin komunal? Sepse qytetarët na akuzojnë shpesh se ne si media marrim fonde, por as tani, as nga pushteti i mëparshëm nuk kemi marrë asgjë nga askush. Kjo kamerë që na ndjek këtu ka kushtuar 10 mijë euro, dhe për kë punon? Për shërbimin publik, që do të thotë se buxheti ynë shkon aty ku nuk duhet, ndërkohë që duhet të vijë nga qendra për mediat tona këtu. Gjithashtu, para disa ditësh ishin të ftuar këtu biznesmenë dhe përfaqësues të fshatrave, por nga fshati Restelicë nuk erdhi askush. Duhej të vinin për të thënë cilat janë interesat dhe priorititet tona, por përkundër kësaj ju vazhdoni të punoni dhe të investoni, por në çfarë mënyre? Vitin e kaluar kishim disa projekte që u nisën, por nuk u përfunduan. Pse nuk u përfunduan? Sepse i plotësuat dëshirat e disa individëve, dhe ne nuk mund të vëmë individin përpara komunitetit. Ne kërkojmë që të rregullohet rruga dhe të vendosen tubat në Gornji Most – Mulliri. Propozojmë që ato që kemi dërguar në mbledhjen publike këtë vit, ato prioritete të futen në buxhet, e jo individët siç tha shefi i zyrës për komunitete. Faleminderit.

Qamil Kolloni: Faleminderit! Ne këtë e kemi planifikuar për KAB. Ne shumë shpejt do ta mbajmë një takim edhe me qytetarët e fshatit Restelicë, pavarësisht ata pse s'kanë ardhë këtu. Më Zyrën për Komunitete, do ta mbajmë një takim të përbashkët me ata qytetarë, dhe projektet të cilat i paraqesin qytetarët, mjete ka të mjaftueshme, do të ekzekutohen dhe realizohen.

Shaqir Skeraj, kryetar i Organizatës për Personat me Aftësi të Kufizuar – Dega në Dragash: Përshëndetje për të gjithë! Unë ndoshta do të dal pak edhe prej temës, ku kemi disa pakënaqësi. Deri para pesë viteve kemi pas të drejtën e regjistrimit të automjeteve pa doganë, ku secilit prej personave me aftësi të kufizuar dikush i dhuron një automjet. Personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për automjet, atë për çdo ditë kanë nevojë të shkojnë nëpër spitale. Pika e dytë është punësimi i personave me aftësi të kufizuar. Në bazë të ligjit, ku thuhet se çdo ndërmarrje publike dhe private që numëron 50 punëtorë, i 51-ti duhet të jetë me aftësi të kufizuara. Në komunën tonë besoj që vetëm një e kemi të punësuar në Qendrën për Punësim. Kërkesat financiare të personave me aftësi të kufizuara, ku ne numërojmë afér 500 anëtarë, neve na mbulohet vetëm për disa persona – deri 10 persona që i paguhet banja secilit veç e veç. Kam kërkue disa herë - 3 Dhjetori është Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara – që t'u blehet fëmijëve me aftësi të kufizuara disa pako. Kjo nuk është realizuar asnjë vit. Gjithashtu, kërkojmë që përmes buxhetit komunal të na bëjnë një zyrë ku mund të kenë qasje personat me aftësi të kufizuara. Ne e kemi një zyrë, por nuk kemi rrymë, nuk kemi qasje në atë zyrë. Të bëhet një zyrë tjetër, ose të renovohet ajo zyrë që e kemi, por le të krijohet qasje edhe për personat me aftësi të kufizuara (gjegjësisht personat me karroca). Faleminderit shumë!

Ismajl Ramadani, përgjegjës i Zyrës së HANDIKOS-it për Dragash: Ju përshëndes të gjithëve! Kam një pyetje për ju. Pasi të bëhet renovimi i Zyrës së HANDIKOS-it në Dragash, a ka në planin afatmesëm të buxhetit mjete përfundimtare e funksionalizimin e fizioterapisë, sepse kërkesat e personave me aftësi të kufizuara janë shumë të mëdha. Unë i furnizoja nga qendra me mjete ortopedike edhe kam. Mirëpo, për moskeqësimin e gjendjes e tyre, sa ka mjete përfundimtare e funksionalizue edhe fizioterapinë këtu, përfundimtare e gjendjes së këtyre personave? A parashihet në buxhetin tuaj? Unë e kam krijuar Databazën me diku 250 anëtarë, shumica janë fëmijë. Përfundimtare e gjendjes së tyre, çka parashihet rrith kësaj? Faleminderit!

Bekim Vehapi, kryetar i fshatit Shajne: Përshëndetje për të gjithë! Unë prapë dola për pyetjen që e bëra në takimin e fundit, kryetari më tha se do t'ju njoftojmë përfundimtare e sotit. A është planifikuar fshati Shajne në projektin dyvjeçar 2026-2027, a ka projekte të mjaftueshme, pasi ne jemi kryesi e re edhe nuk kemi informata a kanë sjellë kryesia para nesh projektet të mjaftueshme përfundimtare dy vite. Edhe, a kanë mbet mjete që ne t'i planifikojmë projektet përfundimtare e investimeve në fshatin Shajne. Duke e pas parasysh

që kemi kërkesa të mjaftueshme të qytetarëve të fshatit Shajne për me paraqit projekte të reja. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Faleminderit! A ka dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë po fillojmë me përgjigjet. Për Zikrijan, këto projekte të cilat i kérkuat ju i kérkuat si qytetar i fshatit Baçkë, unë mendoj që në afatin trevjeçar do të përfshihen të gjitha dhe to të kryhen, sepse ka mjete. Ne presim që ta përfundojmë Ujësjellësin i cili na ka marrë shumë para, edhe Impiantin për pastrimin e ujërave të zeza, dhe mendoj se këto janë pak mejte që kërkon Baçka për me u investue. Shpresojmë se ato prioritete të cilat ju i keni më të rëndësishme t'i planifikojmë me Grupin Punues, bashkërisht me Zyrën për Komunitete dhe nënkyetarin për Komunitete. Të gjitha këto projekte do të janë pjesë e buxhetit për vitin 2026. Mendoj se për këtë rrugën Baçkë-Zlipotok, do ta bëjmë edhe një konsultë me inxhinierët, në qoftë se nuk mund ta kryejmë për një vit, do ta bëjmë një projekt trevjeçar, dhe besoj që për tri vjet do të bëhet funksionale edhe kjo rrugë. Ju garantoj me përgjegjësi të plotë që kjo është e realizueshme. Sa i përket kolegut nga Restelica, m'u dok se i dhashë përgjigje. Sa u përket mediave, duhet të uleni e të bisedoni me kryetarin, është një lëmi pak më e veçantë dhe më specifike. Ne e kemi Fondin për Informim Publik, dhe prej tij ju duhet të lidhni një kontratë të përbashkët për shërbimet të cilat i kryeni. Pasi të bëni një kontratë, ne jemi të gatshëm që t'i parashohim në buxhet dhe t'i mbulojmë ato shpenzime, që të dalin si obligime kontraktuale. Sa i përket Zyrës për të lehtesuar qasjen për personat me aftësi të kufizuara, ne do të mundohmei t'i gjejmë mundësitë dhe ta bëjmë. Nuk janë shumë para, është çështja ku me e gjet një vend. Me ua gjet një pozicion pak më të mirë, me ju sistemue edhe juve. Besoj që edhe kjo do të bëhet. Sa për këto pakot për fëmijë me aftësi të kufizuara, shkruani në letër dhe llogaritni të gjitha vlerat, ne deri në shtator mund ta fusim në buxhet. Sepse, në qoftë se e dimë si shumë, e kemi shumë më lehtë. Prandaj, të lutem, evidentoji të gjitha! Na bjer kërkesën dhe të jesh i bindur se do të jetë pjesë e buxhetit të vitit 2026. Sa i përket Zyrës së HANDIKOS-it, duhet ta bëni një paralogaritje për shpenzimet e renovimit të saj. Sa i përket projekteve të fshatit Shajne, ato janë për 2025-tën. Ju e keni plotësish të drejtën, me kryesinë e re, që ato nevojat që i parashohin qytetarët dhe ju si kryesi, ta bëni një listë, të na bini me shkrim, dhe ne deri në shtator i fusim në buxhet për vitin 2026. Në qoftë se je i interesuar për vitin 2025, çka mund të punohet, mund të vini në zyrë dhe t'i diskutojmë të gjitha. Kërkesat për vitin 2026 ju mund t'i dorëzoni të shkruara! Ne do të mundohemi t'i fusim në buxhet. Në qoftë se nuk mundemi për një vit, i fusim si projekte dyvjeçare. Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe mirë u pafshim!

Linjet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://dragash.rks.gov.net/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-grupe-le-neu-perfjaqesnara-per-kal-2026-2028/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks.gov.net/sr/news/odrzana-je-hndzetska-nasprava-sai-nedorofjna-zastupljenim-grupama-za-kub-2026-2028/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/16aQmxCPlN/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/16E1kZhdSY/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 13.06.2025

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal - Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME GRUPE TË
NËNPËRFAQËSUARA (GRA, VAJZA, PENSIONISTË, PERSONA ME
NEVOJA TË VEÇANTA, TË RINJ DHE KOMUNITETE JOSHUMICË)
PËR KAB 2026-2028**

**LISTA UÇESNIKA NA BUDŽETSKO SASLUŠANJE SA NEDOVOLJNO
ZASTUPLJENIM GRUPAMA (ŽENE, DEVOJKE, PENZIONERI, OSOBE
SA POSEBNIM POTREBAMA, MLADI I NEVEĆINSKE ZAJEDNICE) ZA
SBO 2026-2028**

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivališe	Etnia Etnička pripadnost	M		Nënshkrimi Potpis
				M	Ž	
1	Iscë Bojrami	Shajtare	Kosovar	M	✓	
2	LINDITA PIRMI	Pitave	Rig	✓		
3	Zahid Alifiqi	Shajtare	Rig	✓		
4	Semra Misini	Shajtare	Rig	✓		
5	Leontina Misini	Shajtare	Rig	✓		
6	IBRAHIM KFIZI	Detis	RIGPISTAR	M		
7	SHAGIR JAKUBI PRENC	SHQIPTAR	M			
8	Dreni Myrkza	Zaplluhje	SHQIPTAR			
9	Brendi Ferizhi	Buge	SHQIPTAR	M		
10	Muflita Kujteli	Detis	SHQIPTAR	F		
11	Vlora P. F.	Pitave	Shqiptare	F		
12	Zjedrija Malajeb	BACIA	gjerman	M		
13	Veronika Haxhi	Zaplluhje	SHQIPTAR	M		
14	Azeri Buciku	Buse	Shqiptare	M		
15	REGHAT ALVA	BLAF	SHQIPTAR	M		
16	BETON FERGAS	DRAGASHI	SHQIPTARI	M		
17	JAMAIL Ramadani	KUN	SHQIPTAR	M		
18	Zeni Avramiqi	Buse	Shqiptare	M		
19	Republika Totulan	Kun	Shqiptari	M		
20	Uzur Itay	Kriste	Romaniak	M		
21	Petrit Bocelciu	Pastera	shqiptare	M		
22	Ulimoce Beudin	Buse	shqiptare	M		

REPUBLICA KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash

02 Nr. Br. 400/01-10196/25
13.06.2025
Dragash - Dragash

23	RAIKHM EMINI	KVIC	SHOPIPAR	M	
24	SIRHAN Bayrami	Broad	BESANIL	M	
25	Bishan Salimah	ZUR	Shigipar	M	
26	AROT KALANDERI	KOSAVE	Sister	M	
27	YELI QAFLESHI	BELLOBRAO	SHOPTAR	M	
28	VEZI RESHTI	BRESAN	SHRIPIAR	M	
29	FECUN RUFATI	BESAN	SHRIPIAR	M	
30	Kelvinna Mominah	Besene	Shigipar	M	
31	Aziz Hodeon	Kesetra	Ramnabi	M	
32	Farim Vlana	PZAVI	SHRIPIAR	M	
33	YALINI ALIYA	RAJOLI	GORHISKI	X	D. Henna
34	Fani Kellani	Kosave	Shigipar	V	
35					
36					
37					
38					
39					
40					
41					
42					
43					
44					
45					
46					
47					
48					
49					
50					
51					
52					
53					
54					
55					
56					
57					
58					
59					
60					
61					
62					
63					
64					
65					
66					
67					
68					
69					



